

LICENCË PËR FURNIZIM PUBLIK ME ENERGJI ELEKTRIKE (ME KUSHTE)

DHËNË :

"KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS" SH.A

*Divizionit për Furnizim
("KEK")*

**Numri i Regjistrimit:
ZRRE_Li_07/06**

PASQYRA E PËRMBAJTJËS

PJESA I TERMAT E LICENCËS	2
PJESA II KUSHTET	3
Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet	3
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik	5
Neni 3. Ndalimi i Subvencionimeve dhe Ndër-subvencionimeve.....	6
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit.....	6
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit Elektrik, Kodin..... Matës dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	6
Neni 6: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit.....	6
Neni 7: Mbrojtja dhe Siguria	7
Neni 8: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes	8
Neni 9:Procedurat për Zbulim dhe Parandalimin e Vjedhjeve, Dëmtimeve dhe..... Ndërhyrjeve në Njehsor	8
Neni 10: Rregullat e Tregut	9
Neni 11: Shëndeti dhe Siguria	9
Neni 12: Puna.....	10
Neni 13: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit.....	10
Neni 14: Shërbimet Publike të Detyrueshme	11
Neni 15: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së.....	11
Neni 16: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës	12
Neni 17: Masat dhe Gjobat Administrative	13
Neni 18: Zgjidhja e Kontesteve	14

Shtojcë 1- Të dhënat mbi burrimet materiale në posedim

PJESA I TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji** (tani e tutje "**ZRRE**"), në ushtrim të autoritetit të dhënë nga Neni 15.2(a), 28.2(e) dhe 37 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë(Ligji 2004/9), Nenin 16.2 të Ligjit për Energji (Ligji 2004/8) dhe Nenit 21, 36 dhe 37 të Ligjit për Energji Elektrike (Ligji 2004/10) me anë të kësaj i lëshon, **Korporatës Energjetike të Kosovës- ("KEK") SH.A-Divizionit për Furnizim** (tani e tutje "i Licencuari") licencën për **furnizim publik** të konsumatorëve **me energji elektrike**, sipas Neneve dhe kushteve të vendosura në Pjesën II.
2. Territori i mbuluar me këtë licencë është i tërë territori i Kosovës e sipas Nenit 21.1 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.
3. Kjo licence lëshohet për shitjen e kapaciteteve dhe energjisë elektrike në sasi më shumë se 400 MW.
4. I Licencuari do të lejohet të:
 - a) shes, në baza ekskluzive, energji elektrike konsumatorëve rregulluar (tarifuar) me çmim dhe tarifë të rregulluar, në përputhje me këtë licencë;
 - b) blen kapacitet dhe energji elektrike nga gjeneruesit me një kapacitet të instaluar prej mbi 5MW i cili ekziston në datën e nxjerrjes së Ligjit për Energji Elektrike dhe me çmim të rregulluar;
 - c) blen kapacitet dhe energji elektrike nga gjeneruesit e tjerë sipas procedurës së përcaktuar në Pjesën II, Nenin 6, paragrafi 4;
 - d) importoj dhe eksportoj kapacitete dhe energji elektrike;
 - e) faturon dhe inkason të hyra nga konsumatorët e vet;
 - f) merret me ankesat e konsumatorëve të vet;
 - g) shet energji elektrike konsumatorëve të privilegjuar në përputhje me procedurat që i referohen Nenit 22.4 i Ligjit për Energji Elektrike.
5. Nenet dhe Kushtet e kësaj licence ju nënshtrohen modifikimit ose përfundimit ose tërheqjes në përputhje me termat e tyre dhe me Nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
6. Kjo licencë do të hyjë në fuqi me 4 Tetor 2006 dhe, përderisa nuk tërhiqet, do të jetë në fuqi të plotë dhe efekt për dhjetë (10) vite deri me 4 Tetor 2016, me mundësi vazhdimi bazuar në Rregullin për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me _____.

Nënshkrimi (në emër të Bordit të ZRRE-së) _____

PJESA II KUSHTET

Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet

1. Për qëllim të kësaj licence, termet dhe shprehjet e renditura më poshtë do të kenë këtë kuptim:

"Anëtar" nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

"Certifikata e Origjinës" nënkupton dokumentin e nxjerrë nga ZRRE-ja që evidenton përdorimin e burimeve të energjisë së ripërtitëshme ose mbeturinave për gjenerimin e energjisë elektrike ose të ko-gjenerimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes.

"Kodi i Shpërndarjes" nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

"Sistemi i Shpërndarjes" ka kuptimin siç është dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Operator i Sistemit të Shpërndarjes" ka kuptimin siç është dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Ndërmarrje për energjinë elektrike" ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

"Konsumator i Privilegjuar" ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

"Viti financiar" është periudha prej 1 Janarit deri me 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Kodi i Rrjetit Elektrik" nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit të Energjisë Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

"Shoqeri Aksionare" nënkupton ç' do kompani e definuar si e tillë sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

"Legjislacion" nënkupton Ligjin mbi Energjinë (2004/8), Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligjin mbi Energjinë Elektrike (2004/10) dhe çdo legjislacion tjetër parësor ose dytësor të nxjerrë për ekzekutimin e legjislacionit parësor që rregullon sektorin e energjisë.

"Rregullat e Tregut" nënkuptojnë grup rregullash të miratuara nga ZRRE që udhëheqin tregtinë e energjisë midis Operatorit të Tregut dhe ndërmarrjeve tjera të energjisë elektrike, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit, me qëllim të mirëmbajtjes së balancës fizike të tregut Kjo përfshinë çdo marrëveshje kalimtare mbi tregtimin që do të mund të aprovohej nga ZRRE-ja.

"Rregullat e Tregut" nënkupton rregullat që qeverisin tregtinë me energji elektrike në mes të Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve të tregut dhe bashkëveprimin në mes të këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit për qëllime të mirëmbajtjes së bilancimit fizik të tregut.

"Kodi Matës" nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit të Energjisë Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

"Konsumatorë i rregulluar (tarifor)" nënkupton konsumatorin i cili është i obliguar të blej energji nga Furnizuesi Publik.

"Marrëveshje për Blerje të Energjisë" nënkupton marrëveshjen që referohet në Nenin 21.3 të Ligjit për Energji Elektrike.

"Furnizues Publik" nënkupton personin juridik të licencuar të ushtrij veprimtarinë për furnizim me energji elektrike në Kosovë, sipas Nenit 21 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

"Vartës" nënkupton çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

"Furnizues" nënkupton person juridik të licencuar për të furnizuar me energji elektrike sipas Nenit 20 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

"Furnizim" ka kuptimin të dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike

"Biznes i Furnizimit" nënkupton biznesin e të licencuarit dhe çdo sipërmarrje anëtare ose të ngjashme të të Licencuarit që vepron si furnizues.

"Sistem i Transmisionit" ka kuptimin ashtu siç është dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

"Operator i Sistemit të Transmisionit" ka kuptimin ashtu siç definohet në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

2. Termet e përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në Legjislacion.
3. Duke ju referuar paragrafit 2 çdo modifikim ose ri-dekretim (rishpallje) i legjislacionit që bëhet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj licence, do të aplikohet.
4. Përderisa nuk specifikohet ndryshe:
 - a) çdo referencë në një Nen të numëruar ose në një Shtojcë të numëruar, është respektivisht një referencë në Nenet ose Shtojcën që mbanë atë numër në këtë licencë;
 - b) çdo referencë në paragrafët e numëruar është referencë në paragrafin që e mbanë atë numër në Nenet ose në Shtojcën ku shfaqet referenca.
5. Titulli ose tema e ndonjë Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi nuk do të ndikoj në kuptimin e

saj.

6. Kur të Licencuarit i imponohet për të kryer një detyrim brenda një afati të specifikuar, ai detyrim duhet të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa marrë parasysh masat administrative dhe gjobat që mund të vendosen kundër të Licencuarit, nëse ky i fundit nuk arrin të kryejë aktivitetin e duhur brenda afatit kohor.
7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në çdo dokument që do të paraqitet ose , urdhëresë ose njoftimi dhe shërbimi që duhet të kryhet sipas kësaj licence dhe udhëzimeve të lëshuara prej ZRRE-së.

Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik

Kushti 1:

Sipas Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të përgatisë kontabilitetet vjetore rregullative në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të kontabilitetit vjetor të audituar përgatitur sa më shpejt që është e mundur, dhe i cili duhet të dorëzohet brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiarë që lidhet me kontabilitet.
2. I Licencuari do të mbajë, në kontabilitetin e vet të brendshëm, kontabilitet të veçantë për aktivitetin e Furnizuesit Publik si tërësi si dhe kontabilitetin e veçantë për Furnizim të konsumatorëve të privilegjuar dhe të rregulluar në përputhje me Nenin 49.5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Kur kërkohet kohë pas kohe nga ZRRE-ja, i Licencuari do të dërgon të gjitha llogaritë e tilla ZRRE-së në formën dhe kohën e përcaktuar nga ZRRE-ja. Kontabilitetet duhet të jenë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet ashtu siç mund të nxirren kohë pas kohe nga ZRRE-ja.
3. Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet ose udhëzimet që ZRRE-ja i njofton të Licencuarit sipas paragrafit 2, ndër të tjerash mund të:
 - a) specifikojnë formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis bizneseve të konsoliduara të Furnizimit Publik dhe bizneseve të tjera;
 - b) të specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
 - c) të specifikojë parimet e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).

4. I Licencuari nuk duhet, sa i përket gjendjeve llogaritare në lidhje me vitet financiare, të ndryshoj bazat e pagesave, ndarjen ose alokimin nga ato të aplikuara në vitet e mëhershme financiare, përveç nëse ZRRE-ja ka lëshuar udhëzime për qëllime të këtij Neni ose ZRRE-ja të jap më parë aprovimin me shkrim të ndryshimit në ato baza.
5. I Licencuari do të pajtohet me çdo urdhëresë të nxjerr nga ZRRE-ja.

Neni 3. Ndalimi i Subvencionimeve dhe Ndër-subvencionimeve

1. I Licencuari do të sigurojë se biznesi i furnizimit publik nuk jep ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt ose indirekt) për, as nuk do të pranon ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo indirekt) nga ndonjë biznes tjetër i të Licencuarit dhe/ose ndonjë Anëtar i ose ndërmarrje të lidhur me të Licencuarin dhe/ose ndonjë personi tjetër.
2. I Licencuari gjithashtu do të siguroj se nuk do të lejoj ndonjë ndër-subvencion (drejtpërdrejt ose tërthort) në mes të konsumatorëve të privilegjuar apo jo të privilegjuar të tij, dhe as në mes të ndonjë konsumatori tjetër të tij apo klase konsumatorësh.

Neni 4. Ndalimi i Diskriminimit

I Licencuari në ç'do kohë do t'i zbuloj ZRRE-së rrethanat e shitjes/blerjes ndaj blerësve, përfshirë (pa kufizim) vëllimin, faktorët e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.

Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit Elektrik, Kodin Matës dhe Rregullën mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

Kushti 2:

Sipas Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe pas konsultimit me të Licencuarin, Gjeneruesit dhe Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes dhe Transmisionit, ZRRE-ja mund ti jap të Licencuarit një orar kohorë të implementimit të këtij Neni. Orari kohor i tillë do të zbatohet në ato pjesë të Kodit dhe në atë masë siç precizohet me atë orar.

1. I Licencuari do të veproj sipas dispozitave të Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Kodit Matës për aq sa është e aplikueshme për të.
2. I Licencuari do të veproj sipas Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, që është nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 6: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit

1. I Licencuari do të kryej aktivitete të licencuara në Kosovë në mënyrë efektive, ekonomike dhe të koordinuar.

2. I Licencuari do të ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm që të siguroj dhe implementoj obligimet që dalin në lidhje me legjislacionin që aplikohet me këtë licencë dhe marrëveshjes në të cilën ai është palë.
3. I Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri me urdhëresat apo vendimet e ZRRE-së të bëra sipas legjislacionit.
4. I Licencuari do të lidhë Marrëveshje për Blerje të Energjisë me gjeneruesit e energjisë elektrike, duke ju nënshtruar aprovimit dhe monitorimit të ZRRE-së në përputhje me Nenin 21.3 të Ligjit për Energji Elektrike. Para nënshkrimit të ç' do Marrëveshje për Blerje të Energjisë i Licencuari duhet ta dërgoj atë në ZRRE për miratim.
5. I Licencuari do ti jap përparësi blerjes së energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës në përputhje me Nenin 10.3 dhe 10.4 të Ligjit për Energji Elektrike.
6. I Licencuari do të përgatisë dhe propozoi çdo konsumatori një kontratë për furnizim me energji elektrike në përputhje me Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Neni 7. Mbrojtja dhe Siguria

1. I Licencuari do të informoj konsumatorët e tij për adresën postale, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike të shërbimit të informatave, që themelohet dhe vepron për qëllime të pranimit ta raporteve nga çdo person lidhur me ndonjë çështje apo incident që:
 - a) shkakton ose mund të shkaktojë rrezik ose kërkon vëmendje urgjente sa i përket furnizimit ose shpërndarjes të energjisë elektrike; ose
 - b) dëmton, apo mund të dëmtojë sigurinë, vlefshmërinë apo kualitetin e shërbimit të Sistemit të Shpërndarjes përmes të cilit konsumatori i fundit relevant është i furnizuar me energji elektrike;
 - c) në lidhje me ndonjë ankesë tjetër të bërë nga konsumatori apo ndonjë informatë e kërkuar nga konsumatori.
2. Shërbimi i kërkuar që referohet në paragrafin 1, duhet të jetë:
 - a) i ofruar pa detyrim për konsumatorin;
 - b) i gatshëm të pranojë dhe procedojë raportet telefonike dhe hetimet për çdo ditë të çdo viti; dhe
 - c) operues jo më vonë se deri në ditën që do ta caktojë ZRRE-ja.
3. I Licencuari mund të shkarkohet nga detyrimet e e paragrafin 1 duke dërguar informatën e nevojshme për secilin konsumator:
 - a) në rastin kur konsumatori fillon të furnizohet nga i Licencuari; dhe pas kësaj:
 - (i) kur faturat ose gjendjet në lidhje me ngarkesën e pagesës për furnizim të energjisë elektrike i janë dërguar konsumatorit, në baza tre mujore apo më shpesh (mjafton që informata të përfshihet në ndonjë faturë apo deklaratë); ose
 - (ii) në ndonjë rast tjetër, në bazë vjetore; dhe

- b) duke publikuar këtë informatë në mënyrë që të arrihet publiciteti adekuat .
4. I Licencuari, për aq sa është praktike, do të ndërmerr hapa për të informuar secilit konsumator të tij për çdo ndryshim të adresës, numrit të telefonit, numrit të faksit apo adresës së postës elektronike të shërbimit që i referohet paragrafit 1, para se ky ndryshim të filloj të zbatohet.

Neni 8: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes

1. I Licencuari do të udhëheq me aktivitetet e licencuara në mënyrën që e konsideron më të arsyeshme dhe më të përshtatshme për të arritur standardet e përgjithshme dhe minimale të përmbushjes propozuar nga ai dhe aprovuar nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
2. Brenda gjashtë (6) muajsh nga lëshimi i kësaj licence, i Licencuari do ta përgatisë dhe t'ia dorëzojë ZRRE-së për aprovim propozimin e përmbushjes së standardeve i cili do të:
 - a) identifikojë standardet e përmbushjes së përgjithshme të cilat do të jenë të obligueshëm;
 - b) paraqesë standardet minimale të përmbushjes dhe kualitetin e shërbimeve në lidhje me çështjet specifike në të cilat do të jetë i obliguar të mbështetet kohë pas kohe; dhe
 - c) specifikojë kompensimet financiare që do t'ua caktojë konsumatorëve në rast kur standardet minimale nuk janë në përputhje me nën-paragrafin b.
3. ZRRE-ja mund ta zgjas afatin e paraparë me paragrafin 2 si përgjigje në kërkesën e arsyetuar të të Licencuarit.
4. I Licencuari do të zbatojë standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurat e monitorimit të pajtueshmërisë së të njëjës. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
5. I Licencuari do të rishqyrtojë dhe, nëse duhet, do të propozojë ZRRE-së ndryshimet në standardet e aprovuara, dhe/ose procedurat të realizuara në përputhje me këtë Nen siç udhëzohet nga ZRRE-ja.
6. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 Mars të çdo viti raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet e performimit. Ky raport do të përfshijë aso informatash dhe analizash nëse këtë e kërkon ZRRE-ja kohë pas kohe me qëllim që të vendosë, nëse i Licencuari has apo jo në përmbushjet e përgjithshme, standardet e përmbushjes sipas këtij Neni.
7. I Licencuari me 31 Mars të çdo viti do të publikojë statistikat në mënyrën që ZRRE-ja i kërkon me qëllim të identifikimit të shtrirjes dhe kryerjes apo moskryerjes së standardeve të performancës, të vendosura sipas këtij Neni.

Neni 9: Procedurat për Zbulim dhe Parandalimin e Vjedhjeve, Dëmtimeve dhe Ndërhyrjeve në Njehsor

1. I Licencuari do të marrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të zbuluar dhe parandaluar:

- a) vjedhjen e energjisë elektrike në pronat që furnizohen nga ai;
 - b) dëmtimin apo defektet në ndonjë ndërmarrje energjetike, vijë elektrike apo njehsor elektrik përmes të cilit këto prona furnizohen;
 - c) ndërhyrjen në ndonjë njehsor elektrik përmes të cilit këto prona janë furnizuar; dhe
 - d) ndonjë konsumim të paregjistruar të energjisë elektrike në pronat që furnizohen nga ai.
2. I Licencuari, sa më parë që të jetë në mënyrë të arsyeshme e praktikueshme, do të informojë pronarin e centralit elektrik përkatës, vijave elektrike apo njehsorit për ndonjë incident ku ai ka arsye të besojë:
- a) se ka dëme apo defekte në ndonjë central elektrik, në vije elektrike apo njehsor; ose
 - b) se ka pasur ndërhyrje në njehsor për të ndryshuar regjistrimin e tij ose për të penguar regjistrimin ditor të sasisë së energjisë së furnizuar; ose
 - c) se konsumi i energjisë elektrike në objektet që furnizohen nga ai nuk janë regjistruar.
3. Kur i Licencuari ka arsye të besojë se ndonjë incident i raportuar tek pronari në përputhje me paragrafin 2 është shkaktuar nga akti i ndonjë personi duhet, në përputhje me kërkesat e shtruarra me këtë paragraf, ti ofroj pronarit këto informata siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme për qëllimet e hetimit të incidentit dhe të zgjedhjes së ndonjë brenge të sigurisë që mund të ngritët nga ai.
4. Në këtë Nen:

“Vjedhje e energjisë elektrike” nënkupton përdorimin e pandershëm, shpërdorimin apo diversionin e energjisë elektrike.

Neni 10: Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të jetë pjesëmarrës dhe do të veproj në përputhje me Rregullat e Tregut deri sa ato të jenë të aplikueshme për të.
2. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime që lirojnë të Licencuarin nga obligimet e veta sipas paragrafit 1 më lart sa i përket këtyre pjesëve të Rregullave të Tregut dhe në atë masë që mund të specifikohet në këto udhëzime.

Neni 11: Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari do të ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat dhe pronën nga lëndimi dhe dëmtimi që mund të shkaktohen nga i Licencuari gjatë kryerjes së biznesit të Furnizimit Publik.
2. I Licencuari do të sigurojë që një ekspert i pavarur, caktimin e të cilit e ka aprovuar ZRRE-ja, do të bëjë një kontrollim vjetor teknik dhe të sigurisë në lidhje me sistemin e furnizimit.
3. I Licencuari me kohë do t'i ofroj ZRRE-së rezultatet e kontrollit të tillë.

Neni 12: Puna

I Licencuari do të veprojë në pajtim me të gjithë legjislacionin e aplikueshëm mbi punën dhe sigurinë në punë që është në fuqi tani ose që do të hynë në fuqi në të ardhmen.

Neni 13: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.

Neni 14 : Shërbimet Publike të Detyrueshme

1. I licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik i cili do të vihet nga ZRRE-ja në përputhje me Nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Kur të Licencuarit i janë ngarkuar shërbimet publike të obligueshme, ata do të lejohet që ta rikthejnë çdo shpenzim të arsyeshëm plotësues që është paraqitë:
 - a) në mënyrën e caktuar në këtë Nen lidhur me shpenzimet për furnizim nga burimi i fundit; ose
 - b) në mënyrat tjera të caktuara nga ZRRE-ja.
2. ZRRE-ja mundet, që me njoftim me shkrim të udhëzojë të Licencuarin që të furnizoi me energji elektrike cilindo konsumator në përputhje me këtë Nen ("udhëzimi për furnizimin nga burimi i fundit").
3. Paragrafi 2 aplikohet kur ZRRE-ja vlerëson se:
 - a) janë krijuar rrethanat që do të detyronin ZRRE-në të tërheq licencën për furnizim të ndonjë Furnizuesi të energjisë elektrike tjetër prej të Licencuarit ("furnizuesi tjetër"); dhe
 - b) i Licencuari mund të pajtohet me udhëzimin për furnizim nga burimi i fundit pa paragjykuar plotësisht aftësitë e tij:
 - (i) të vazhdojë të furnizojë konsumatorin e tij; dhe
 - (ii) të përmbush obligimet e tij kontraktuese për furnizim me energji elektrike.
4. Udhëzimi për furnizim nga burimi i fundit do të hyj në fuqi prej datës së revokimit të licencës së furnizimit të Furnizuesit tjetër dhe do të vazhdojë për një periudhë që nuk është më e gjatë se gjashtë (6) muaj të specifikuar në udhëzim.
5. I licencuari do të furnizoi me energji elektrike konsumatorët që më parë furnizoheshin nga Furnizuesi tjetër në ato ndërtesa siç i janë specifikuar ose përshkruar në udhëzimin për furnizim nga burimi i fundit.
6. Sa më shpejtë që është e arsyeshme, pasi që ZRRE-ja të ketë aprovuar dhe publikuar udhëzimin për furnizim nga burimi i fundit, I Licencuari do të dërgojë një kopje të njoftimit në secilën ndërtesë të specifikuar ose përshkruar në udhëzimin për furnizim nga burim i

fundit. Njoftimi që do të dërgohet në të gjitha ndërtesat e specifikuara ose të përshkruara në udhëzimin për furnizim nga burim i fundit, do të:

- a) informojë konsumatorin në fjalë se ai nuk do të furnizohet më tej nga Furnizues tjetër dhe se nuk është furnizuar nga Furnizuesi tjetër që nga data në të cilën udhëzimi ka hyrë në fuqi;
 - b) informojë konsumatorin në fjalë se i Licencuari është bërë Furnizues i energjisë elektrike për konsumatorin nga data e hyrjes në fuqi të udhëzimit; dhe
 - c) vendos detyrime që duhet të paguhet për furnizim me energji sipas udhëzimit ose me një shpjegim se si janë përcaktuar detyrimet.
7. I Licencuari mund të ngarkojë me pagesë për furnizim me energji elektrike në pronat e specifikuara ose të përshkruara në udhëzimin për furnizim nga burim i fundit me çmim që nuk është më i madh se shpenzimet e arsyeshme të furnizimit të të Licencuarit (duke përfshirë shpenzimet e mundshme për blerje të energjisë elektrike me njoftime të shkurtra) së bashku me një përfitim të arsyeshëm.
 8. Kur i Licencuari të lidh kontratë të re për blerje të energjisë elektrike me qëllim që të përmbush obligimet e tij sipas këtij Neni, duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të bërë blerjen në mënyrë sa më ekonomike që është e mundur në të gjitha rrethanat.
 9. Kur i Licencuari konsideron të domosdoshëm, në llogari të çmimeve më të larta nga kontrata e re për blerjen e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve e sipas udhëzimit mbi furnizimin nga burimi i fundit, për ti ngritur çmimet nga ato të deritashme me të cilat i ka ngarkuar konsumatorët ekzistues, i Licencuari duhet të bëjë kërkesë ZRRE-së që t'ja miratoj aso çmimesh të larta. Çdo kërkesë e tillë duhet ti dërgohet ZRRE-së brenda një (1) muaji nga data kur udhëzimi ka hyrë në fuqi.
 10. Kur i Licencuari nuk mundet me i rikthyer të gjitha shpenzimet lidhur me obligimet e furnizimit nga burimi i fundit nëpërmes çmimit të furnizimit të konsumatorëve e sipas udhëzimit për furnizim nga burimi i fundit, ai mund të njoftojë ZRRE-në duke kërkuar miratimin për ti rikthyer shpenzimet e bëra plotësuese nga të gjithë konsumatorët e tij. Njoftimi i dërguar ZRRE-së duhet të përfshijë një llogaritje të shumëve relevante me informatat shtesë dhe duhet që ZRRE-ja ta marr brenda gjashtë (6) muajve nga udhëzimi për furnizim nga burimi i fundit i cili atëherë përfundon..
 11. Shuma totale e pagesës shtojcë për furnizim nga burim i fundit të cilën e kërkon i Licencuari ("shuma relevante") nuk do të tejkalojë shumën sipas të cilës shpenzimet totale (përfshirë interesin për kapitalin punues) që shkaktohet në mënyrë të arsyeshme nga i Licencuari si rezultat i udhëzimit për furnizim nga burimi i fundit, bashkë me një fitim të arsyeshëm, janë më të mëdha se shumat e materialeve të mbuluara nga i licencuari sipas borxheve për energjinë e furnizuar në pronat sipas udhëzimit për furnizim nga burimi i fundit (pas marrjes së të gjithë hapave të arsyeshëm për mbulimin e këtyre shpenzimeve).

Neni 15: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë informacionin ZRRE-së, në mënyrën dhe në afatet siç kërkohet nga ZRRE-ja, si dhe do t'i sigurojë dhe japë ato raporte që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme duke marrë parasysh cilindo Nen apo Kusht të kësaj licence, ose për qëllimin e

kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar atij sipas Nenit 29 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë apo legjislacionit tjetër të aplikueshëm.

2. Informata do të përgatitet në nivel të auditimit ashtu siç mund të kërkohet nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
3. Autoriteti i ZRRE-së për të kërkuar informacion sipas paragrafit 1 nuk i cenon kompetencat e ZRRE-së që të kërkoj edhe ato informata që konsiderohen konfidenciale sipas çdo Neni apo Kushti tjetër të kësaj licence ose sipas Legjislacionit të aplikueshëm.
4. Nëse i Licencuari kërkon që ndonjë informatë të konsiderohet si konfidenciale, ai ka për obligim që të shënoj informatën e tillë si konfidenciale dhe të justifikon ZRRE-së këtë.
5. I Licencuari do të themeloj lidhje komunikuese me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut duke emruar personin i cili në emër të tij do të komunikoj me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut. Adresa, numri i telefonit, faksit apo adresa elektronike e personit të tillë do të dërgohet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut.
6. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së çdo kontratë të nënshkruar për furnizim, Marrëveshjet për Blerje të Energjisë Elektrike dhe çdo kontratë të nënshkruar në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike.
7. I licencuari do të dorëzoj në ZRRE raportet tremujorshe dhe vjetore mbi veprimtarinë e furnizimit publik si dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e licencës e që është në përputhje me Doracakun e Raportimit të nxjerr nga ZRRE-ja.
8. I licencuari do të dërgoj ZRRE-së detajet mbi çdo ndryshim të informatave të dërguara me aplikacionin për këtë licencë.
9. Në këtë Nen:

"Informacioni" është material në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 16: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës

1. ZRRE-ja mund të përfundojë këtë licencë sipas Nenit 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nëse obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të pa lakmueshëm për shkak të përfundimit. Përfundimi i licencës do të ndërmerret në rast të:
 - a) skadimit të afatit të licencës;
 - b) me kërkesën e ndërmarrjes së licencuar të energjisë lidhur me licencën e tij;
 - c) shpërbërjen e personit juridik që mban licencën;
 - d) pas vendimit të gjykatës me të cilin shpall falimentimin e të licencuarit apo vendimit të gjykatës për përfundimin e aktiviteteve të energjisë për shkak të shpalljes së likuiditetit të të licencuarit;

- e) nëse aktiviteti i licencuar për energji nuk është ushtruar më shumë se gjashtë (6) muaj, përpos kur ndërprerja e aktivitetit është bërë me miratimin e ZRRE-së;
 - f) nëse janë plotësuar kushtet nga dispozitat e Nenit 44 të Rregullit për Liçencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
 - g) nëse shuma e caktuar e tarifës nuk është paguar tridhjetë (30) ditë nga data e caktuar dhe ka mbetur e papaguar edhe për një periudhë tjetër prej tridhjetë (30) ditësh pas vërejtjes me shkrim të dhënë nga ZRRE-ja në lidhje me vonesën e pagesës me kusht që asi vërejtje nuk do të lëshohet më herët se data kur shuma është dashur të paguhet.
2. ZRRE-ja mund të tërheqë këtë licencë në rastet e paraqitura më poshtë si është përcaktuar në Nenin 44.5 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, në rast se këto detyrime të të Licencuarit do të kryhen prej një të Licencuari tjetër ose që konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të disfavorshëm nga kjo tërheqje:
- a) i Licencuari nuk i plotëson kushtet e Neneve apo obligimet nga licenca apo edhe i shkel ato, dhe se ai mosplotësim apo shkelje nuk është ndrequr brenda afatit të caktuar nga ZRRE, apo ka dëmtuar seriozisht kualitetin, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që përndryshe i Licencuari ishte i obliguar ta ofroj;
 - b) nëse gjatë monitorimit të licencës nga ZRRE gjenden dështime në përmbushjen e kërkesave administrative dhe se ato dështime nuk janë eliminuar brenda afatit të caktuar nga ZRRE;
 - c) i Licencuari prezanton informata materiale false në bazë të të cilave është dhënë licenca.
3. Sipas Nenit 35 të Rregullit për Liçencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë ZRRE mund ta modifikoj këtë licencë në rastet si në vijim:
- a) me kërkesën e të Licencuarit;
 - b) kur kërkohet të mbrohet sistemi energjetik në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit, sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, ose mbrojtjen e ambientit;
 - c) në mënyrë që t'u plotësohen kërkesat e reja të paraqitura në marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet vendore, rregulloret dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm;
 - d) si sanksion për shkeljen e kushteve dhe konditave të licencës, sipas Nenit 44 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Neni17: Masat dhe Gjobat Administrative

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit, Neneve dhe kushteve të kësaj Licence apo instruksioneve dhënë të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca që sipas Nenit 56.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Masat dhe Gjobat Administrative ose ta parandaloj të Liçencuarin që ti përsëris veprimet ilegale apo në rast se veprimi është ndalur, ZRRE mund të lëshoj vendim me të cilin kërkohet që të ndërmerren veprime konkrete apo ta ngarkoj me gjoba administrative të licencuarin dhe/apo anëtarin e Bordit të Drejtorëve dhe/apo ekzekutivin e saj.
2. Para se të jepet gjoba ZRRE do ti lëshoj të licencuarit një njoftim mbi shkeljet e bëra dhe do ti ofroj mundësi që brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të njoftimit të përgjigjet me shkrim për të përmirësuar shkeljen.
3. Gjoba do t'i caktohet të Licencuarit në pajtim me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e

Energjisë dhe Rregullin për Gjobat dhe Masat Administrative.

4. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Rregullin për Masat dhe Gjobat Administrative. Sidoqoftë nëse gjoba nga paragrafi 3 i ngarkohet të Licencuarit ajo nuk mund ta tejkaloj 15% e të ardhurat nga veprimtaria e ushtruar sipas kësaj licence në vitin financiar paraprak.
5. Nëse gjoba nga paragrafi 3 i është ngarkuar anëtarit të Bordit të Drejtorëve apo ekzekutivit të të Licencuarit ajo nuk duhet të tejkaloj 300% e pagës mujore që ai person ka pranuar nga i Licencuari.
6. Në rast të përsëritjes së shkeljes, gjoba e ngarkuar mund të jetë tre (3) herë më e lartë se shumta e autorizuar me paragrafin 4 apo 5.
7. Kur të vë një gjobë, në përputhje me këtë Nen, ZRRE-ja duhet të ketë parasysh shkallën e dëmtimit të shoqërisë nga ai veprim, sjelljen e mëparshme të të Licencuarit apo ose të personit, dhe gjendjen financiare të të Licencuarit dhe personit.
8. Nëse gjoba e ngarkuar nga ZRRE-ja nuk është paguar, ZRRE do të inicioj procedurën gjyqësore për të marr gjobën si borxh civil.

Neni 18: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është në lidhje me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet sipas Rregullës për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me modifikimin, tërheqjen apo përfundimin e licencës, si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të apeloher nga i Licencuari në Gjykatën kompetente.